




DISCOVER

— ITS BEAUTY —

Zbulo Bukurinë e Islamit



E Vërteta Përfundimtare në Islam është

Të gjithë Profetët dhe të Dërguarit e Zotit, përfshirë Ademin, Nahun, Ibrahimin, Musain, Isain dhe Muhamedin, u dërguan nga Zoti, Allahu, Krijuesi absolut. Ata të gjithë përcollën të njëjtin mesazh të përjetshëm:

“Ky është Allahu, Zoti juaj, nuk ka të adhuruar të vërtetë përveç Tij, Krijuesi i çdo sendi, pra adhurojeni Atë.”

Për më shumë informata dhe bashkëbisedim vizito:



www.discoveritsbeauty.com

Konceptet kryesore të besimit Islam janë

Allahu është emri i Zotit të vetëm të vërtetë, Krijuesit absolut. Allahu është Zoti i vërtetë i mbarë njerëzimit dhe i të gjitha botëve.

Muhamedi ﷺ (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) është i Dërguari i fundit i Allahut. Zoti e dërgoi atë për të gjithë njerëzimin.

Kurani është Fjala përfundimtare e Allahut (Zotit), e shpallur Profetit Muhamed ﷺ.

Islam do të thotë nënshtrim ndaj Allahut, Zotit të vetëm.

Musliman është ai që i nënshtrohet Allahut dhe e adhuron vetëm Atë.

Porta drejtë Lumturisë dhe Shpëtimit në Islam është
(Dëshmia e Besimit - Shehadeti)

“Dëshmoj se nuk ka Zot të denjë për adhurim përveç Allahut, dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i Dërguar i Allahut.”

(Dëgjoje këtë dëshmi në arabisht)

Kjo është dëshmia e besimit që duhet shqiptuar për të përqaftuar Islamin; ajo përmbledh të vërtetën, bukurinë dhe thjeshtësinë e Islamit.



Albanian